



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH

Njesia Org. Nr. Prot.
Org. Jedinica Org. Unit 02 Broj Prot. 05-4366
Prot. No.
Nr. i faqeve Data:
Br. stranica Datum:
No. pages 11 Date: 18.07.2023

Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE (PSO)

EMRI I PSO: INICIMI I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT PËR KONTRATË PËR PUNË NDËRTIMORE

PËRMBAJTJA: PËRSHKRIMI I KËRKESAVE TË CILAT DUHET PLOTËSUAR PARA INICIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT PËR KONTRATË PËR PUNË NDËRTIMORE

VERSIONI: [1.0]

DATA E APROVIMIT: [17/07/2023]

AUTOR: [MSH]

NR. I HAPAVE: [07]

NR. I NËNHAPAVE: [025]

APROVUAR:

Dr. Naim Bardiqi

Sekretari i Përgjithshëm MSH



QËLLIMI	PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE PËR INICIMIN E AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT PËR KONTRATAT PËR PUNË NDËRTIMORE KA PËR QËLLIM QË TË RREGULLOJË PROCESIN DHE PROCEDURAT PËR INICIM TË AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT PËR KONTRATAT PËR PUNË NDËRTIMORE, BAZUAR NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, DUKE PËRFSHIRË TË GJITHË AKTERËT E PËRFSHIRË NË PROCESIN E PROKURIMIT, NË FAZËN PARA-TENDERUESE.
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ul style="list-style-type: none"> ▪ LIGJI NR. 04/L-042 - LIGJI I PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-237, LIGJIN NR. 05/L-068 DHE LIGJIN NR. 05/L-092; ▪ A01 RREGULLORE NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK; ▪ LIGJI NR. 04/L - LIGJI PËR NDËRTIM; ▪ LIGJI NR. 04/L-175 - LIGJI PËR INSPEKTORATIN E MJEDISIT, UJËRAVE, NATYRËS, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE NDËRTIMIT; ▪ LIGJI NR. 03-139 - LIGJI PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME, LIGJI NR. 03/L-205 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SE PALUAJTSHME; ▪ LIGJI NR. 04/L-174 - LIGJI PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR; ▪ LIGJI NR. 03/L- 025 - LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT; ▪ UA MMPH-NR.04/2017 PËR KATEGORIZIMIN E NDËRTIMEVE; ▪ UA MMPH NR.06/2017 PËR CAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRGATITJEN DHE SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR KUSHTE NDËRTIMORE, LEJE NDËRTIMORE DHE LEJE RRËNIMI PËR KATEGORINË E I-RË DHE TË II-TË TË NDËRTIMEVE; ▪ UA MMPH NR. 01/19 PËR CAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRGATITJEN DHE SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR KUSHTE NDËRTIMORE, LEJE NDËRTIMORE DHE LEJE RRËNIMI PËR KATEGORINË E III-TË TË NDËRTIMEVE; ▪ UA MMPH NR.08/2013 PËR NDËRTIMET PËR TË CILAT NUK KËRKOHET LEJE NDËRTIMORE; ▪ UA MMPH NR.05/2017 PËR MBIQYRJE INSPEKTUESE DHE PROCEDURËN PËR LËSHIMIN TË CERTIFIKATËS SË PËRDORIMIT; ▪ RREGULLA FINANCIARE 01/2013 / MF - SHPENZIMI I PARAVE PUBLIKE; ▪ LIGJI NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE, I PLOTWSUAR DHE NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 05/L-007, ME LIGJIN NR. 03/L-221, NR.04/L-116, NR. 04/L-194 DHE NR. 05/L-063;
LISTA E SHKURTESAVE	<ul style="list-style-type: none"> ▪ AQP - AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT; ▪ DNPFD - DEKLARATA E NEVOJAVE DHE PËRCAKTIMIT TË DISPONUESHMËRISË SË FONDEVE; ▪ LPP - LIGJI I PROKURIMIT PUBLIK; ▪ MMPH - MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR; ▪ MSH - MINISTRIA E SHËNDETËSISË; ▪ OE - OPERATORI EKONOMIK; ▪ SNJK - STAFI I NJËSISË KËRKUESE (DIVIZIONI); ▪ TEMF - TENDERI EKONOMIKISHT MË I FAVORSHËM; ▪ UA - UDHËZIMI ADMINISTRATIV; ▪ UDNJK - UDHËHEQËSI I DIVIZIONIT TË NJËSISË KËRKUESE; ▪ ZKA - ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV; ▪ ZKF - ZYRTARI KRYESOR FINANCIAR; ▪ ZPP - ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT; ▪ ZSP - ZYRA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM;

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN - HAPAT
[I]	Hartimi i Planit të Veprimit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Para hartimit dhe publikimit të planit përfundimtar të prokurimit, respektivisht pas aprovimit të planit preliminar të prokurimit, ZKA themelon grupin punues për hartim të Planit të Veprimit për secilin aktivitet të prokurimit për kontratat për punë ndërtimore. 2. Grupi punues harton dhe miraton Planin e Veprimit për kontratat për punë ndërtimore dhe e njofton ZKA. 3. Pas miratimit të Planit të Veprimit, secili aktivitet i paraparë i cili ndërlidhet me inicim të procedurave të prokurimit, inkorporohet në Planin Përfundimtar të prokurimit.
[II]	Hartimi i Projektit Kryesor	<ol style="list-style-type: none"> 1. SNjK, në pajtim me Ligjin e ndërtimit, Neni 16, Neni 25.1 dhe UA të MMPH Nr.08/2013, përcakton nëse për procedurën e planifikuar për inicim duhet pajisur me leje ndërtimi apo jo. 2. SNjK, në pajtim me UA të MMPH Nr.04/2017, përcakton kategorinë e aktivitetit të ndërtimit, ashtu që pastaj edhe definon procesin administrativ për pajisje me leje adekuate për inicimin e atij aktiviteti. Për kategorinë I dhe II lejet lëshohen nga Komuna, ndërsa për kategorinë III nga MMPH. 3. SNjK në bashkëpunim me përfituesit e projektit harton Detyrën Projektuese, në të cilën definohet në detaje kërkesa e investitorit në bazë të së cilës hartohet projekti i kërkuar, varësisht nga faza e përcaktuar me UA MMPH Nr.06/2017. SNjK sipas nevojës angazhon edhe ekspertë të fushës. 4. Pas hartimit të Detyrës Projektuese, UDNjK e inicion procedurën për “Hartimin e Projektit Konceptual / Ideor dhe Kryesor”, përmes procedurave të prokurimit. 5. Pas kontraktimit të Kompanisë Projektuese, fillon zbatimi i kontratës së hartimit të Projektit Konceptual / Ideor dhe Projektit Kryesor. 6. SNjK, në koordinim me drejtorinë komunale përgjegjëse për urbanizëm, siguron kushtet ndërtimore/lejen dhe pëlqimet për kyçe në infrastrukturë. Nëse ndërtimi është i kategorisë III apo kombinim i kategorisë II dhe III atëherë leja kërkohet nga MMPH konform UA MMPH Nr.01/2019. 7. Kompania Projektuese harton dhe dorëzon Projektin Kryesor, Përshkrimin teknik, Para masën dhe Para llogarinë të NjK.

		<p>8. UDNjK inician marrjen e Lejes së Ndërtimit, duke përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis apo lejen mjedisore konform legjislacionit përkatës.</p>
[III]	Përgatitja e Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve (DNPDF)	<p>1. UDNjK përgatit Kërkesën për Tenderim, draft kërkesat specifike të kualifikimit, specifikimin teknik (dokumentacionin e projektit), Deklaratën nën Betim për hartuesit e specifikimeve teknike dhe Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP, B04.</p> <p>2. Në kërkesën për tenderim duhet të përcaktohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> kohëzgjatja e kontratës; koha e fillimit të implementimit të kontratës; numri i loteve, nëse aplikohet; kufizimi në shpërblim të loteve, nëse aplikohet; periudha e garancionit, nëse aplikohet; <p>3. Pas kompletimit të dokumenteve të listuara më lartë, UDNjK dorëzon dokumentet për miratim tek ZKF.</p>
[IV]	Aprovimi nga ZKF	<p>1. ZKF aprovon Deklaratën e Nevojave dhe bën zotimin e mjeteve.</p> <p>2. Nëse deklarata nuk aprovohet, kthehet te UDNjK për plotësim. Deklarata e Nevojave e aprovuar, nga ZKF dërgohet te ZKA për aprovim.</p> <p>Shënim: <i>Me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit, MSh duhet të sigurohet se me buxhetin vjetor ekziston ndarja buxhetore për atë aktivitet të paraparë të prokurimit. Nëse kjo është siguruar, atëherë MSh mund të ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme të prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës. Nëse një aktivitet i prokurimit parashihet të zgjasë më shumë se një vit dhe krijohen obligime kontraktuale nga ndarjet buxhetore në vitet e ardhshme fiskale, atëherë ZKF do të sigurojë që tabelat e bashkangjitura të buxhetit për vitet e ardhshme sigurojnë fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (neni 9.3 i LPP).</i></p>
[V]	Aprovimi nga ZKA	<p>1. ZKA vlerëson arsyeshmërinë e aktivitetit të prokurimit dhe e aprovon apo refuzon.</p> <p>2. Nëse Deklarata e Nevojave aprovohet, deklarata e nënshkruar dorëzohet tek Divizioni i Prokurimit, ndërsa nëse nuk aprovohet kthehet te UDNjK.</p> <p>Shënim:</p>

		<i>Vlerësimi i nevojave ka për qëllim që të evitohet prokurimi jo-efikas duke u siguruar se prokurimet janë të sakta, të nevojshme, si dhe të sigurohet që lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik. Asnjë aktivitet i prokurimit nuk mund të iniciohet para se të jetë nënshkruar Deklarata e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve.</i>
[VI]	Obligimet e ZPP – së para inicimit të procedurës	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pas pranimit të Kërkesës për Tenderim, draft kërkesave specifike të kualifikimit, specifikimin teknik (dokumentacionin e projektit), Deklaratën nën Betim për hartuesit e specifikimeve teknike dhe Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, ZPP kontrollon dokumentacionin, si dhe ndërmerr hapat e më poshtëm: 2. Nëse aktiviteti i prokurimit nuk është planifikuar dhe nuk është dhënë arsyeshmëria për mos përfshirje në planifikim, ZPP me e-mail e njofton UDNjK dhe kthen prapa deklaratën dhe kërkon arsyeshmërinë. 3. Nëse aktiviteti i prokurimit nuk është i planifikuar por është i buxhetuar dhe është dhënë arsyeshmëria, ZPP dorëzon deklaratën në AQP, 5 ditë para inicimit të aktivitetit të prokurimit. 4. Nëse aktiviteti i prokurimit është i planifikuar, ZPP me e-mail njofton UDNjK dhe kërkon dorëzimin e projektit dhe dokumentacionit në mënyrë elektronike. <p>Shënim: <i>Nëse projekti kapital është i ri dhe nuk është i përfshirë në ligjin e buxhetit për vitin përkatës, për bazë duhet të merret Neni 16 Pika 8 e Ligjit të Buxhetit e cila e rregullon çështjen e futjes së projekteve të reja në tabelat buxhetore.</i></p>
[VII]	Obligimet e ZPP – së pas pranimit të dokumenteve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pas pranimit të dokumenteve nga UDNjK, ZPP kontrollon dokumentet duke përdorur Listën Kontrolluese, Aneksin 4. 2. Nëse nuk janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në listën Kontrolluese, ZPP kërkon plotësimin e të dhënave nga UDNjK. 3. Nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në listën Kontrolluese, ZPP vazhdon me përgatitje dhe publikim të aktivitetit.
SQARIM		<p>Shtojca të kësaj PSO, janë:</p> <p>Shtojca 1: Kërkesat specifike të kualifikimit;</p>

	Shtojca 2. Kriteri i shpërblimit; Shtojca 3: Deklarata nën Betim për hartuesit e specifikimeve teknike; dhe Shtojca 4. Lista Kontrolluese;
--	--

Shtojca 1: Kërkesat Specifike të Kualifikimit

Shënim: Kërkesat e mëposhtme të përcaktuara nga NjK mund të shtohen apo të largohen, varësisht nga natyra dhe vlera e projektit.

Kërkesat e kualifikimit janë përgjegjësi e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, prandaj ZPP do ti shqyrtoj dhe në rast se vëren kufizime mund ti ndryshoj. Në këtë rast ZPP njofton Njësinë e Kërkesës për ndryshimet e bëra.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, së bashku për të tre vitet, prej jo më pak se: *(të përcaktohet shuma nga NjK)*. **SHËNIM:** *Maksimum 2 herë i vlerës së parashikuar të kontratës.*

Evidenca 1. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo në vendin e themelimit.

Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të ketë mjete financiare të mjaftueshme për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku: *(të përcaktohet shuma nga NjK)*. **SHËNIM:** *Maksimum 1/5 e vlerës së parashikuar të kontratës*; ose dëshmi për qasje në kredi nga një bankë, për të njëjtën vlerë, në emër të të njëjtit Aktivitet të Prokurimit.

Evidenca 2. Dokument i lëshuar nga institucioni bankar i cili dëshmon se Operatori Ekonomik posedon mjetet e gatshme financiare në bankë ose dokument i lëshuar nga institucioni bankar i cili dëshmon se Operatori Ekonomik do të ketë qasje në kredi për të njëjtën vlerë. Dokumenti duhet të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme *(të përcaktohet lloji i kontratave të ngjashme nga NjK)*, në 3 (tre) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë, në vlerë minimale prej: *(të përcaktohet shuma nga NjK)*. **SHËNIM:** *maksimum 1.5 herë i vlerës së parashikuar të kontratës.*

Evidenca 1. Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar: titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj me Ofertën e tij “Planin Dinamik të Detajuar” për secilin pozicion të përshkruar në Para masë. Për secilin pozicion të përshkruar në para masë duhet të shënohet numri i ditëve (dita e fillimit dhe dita e përfundimit) të pozicionit. Gjithashtu, së paku në rreshtin e fundit, të shënohen të dhëna për numrin e përgjithshëm të punëtorëve dhe stafit të OE, të angazhuar në punishte, në ditën e caktuar në “Planin Dinamik”. Në planin dinamik të shënohen ditët e pushimit (ditët e diela) si dhe ditët e festave, sipas kalendarit të festave të Republikës së Kosovës.

Evidenca 2. Plani dinamik i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.

Kërkesa 3. OE duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon:

- 3.1 Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master i diplomuar (menaxher i projektit) – drejtimi konstruktiv me më së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit.
- 3.2 Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master i diplomuar – drejtimi hidro, me më së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit.
- 3.3 Një (1) inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose master i diplomuar me më së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit, me licencë valide nga AKK.
- 3.4 Një (1) inxhinier i diplomuar i makinerisë (drejtimi termoenergjetik) ose master i diplomuar me më së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit.
- 3.5 Një (1) inxhinier i diplomuar i Arkitekturës ose master i diplomuar me më së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit.
- 3.6 Një (1) inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose master i diplomuar me më së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit.
- 3.7 Një (1) inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i diplomuar me më së paku pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

Evidenca 3. Lista e stafit, Kopja e CV-së, kopja e Diplomës, kopja e Kontratës së punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete ose ti ketë në shfrytëzim, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e kontratës: Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm si më poshtë *(të specifikohen pajisjet nga NjK)*.

Evidenca 4. Deklaratat unike doganore ose kontrata/fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

Shtojca 2: Kriteret e Shpërblimit

Shënim: Kriteret e shpërblimit të shënuara si më poshtë të TEMF, mund të kërkohen dhe nuk janë kriteret e vetme që mund të përcaktohen në aktivitetin e prokurimit nga UDNjK. Mund të shtohen apo të largohen, varësisht nga natyra dhe vlera e projektit. Megjithatë ZPP do të shqyrtoj dhe në rast se vëren kufizime, mund t'i ndryshoj në bashkëpunim me UDNjK.
SHËNIM- NjK përzgjedh njërin dhe fshin tjetrën.

1. **Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ultë;** apo
2. **Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm,** i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara më poshtë.

Në rast se përzgjidhet tenderi ekonomikisht më i favorshëm, përcakto nën-kriteret, si shembull¹:

Nën-kriteri	Pesha në pikë
Çmimi	70
Afati më i shkurtë i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në maksimum 250 ditë	20
Afati më i gjatë i periudhës garantuese deri në maksimum 5 vite	10
Total:	100

¹ Totali i peshës duhet të jetë 100. Mund të shtohen kriteret tjera.

Shtojca 3: Deklarata nën betim

DEKLARATA NËN BETIM

Ky formular duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga Personat/Grupet punuese të cilët kanë përgatitë Specifikimet Teknike/Termat e Referencës. Një kopje e deklaratës së nënshkruar duhet të dorëzohet në Divizionin e Prokurimit, së bashku me Specifikimet Teknike.

Unë, i nënshkruari, (Emri & Mbiemri) _____, i lindur më (data e lindjes) _____, në (vendi i lindjes) _____, (shënoni pozitën) _____, deklaroj nën betim se:

1. Kam përgatitur Specifikimet teknike/Termat e Referencës të bashkangjitura për aktivitetin _____ (shëno titullin e aktivitetit);
2. Që specifikimet teknike janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, në përputhje me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe legjislacionin e tij implementues;
3. Që specifikimet teknike janë përgatitur në atë mënyre që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik;
4. Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi; dhe
5. Pranoj që personalisht mund të konsiderohem përgjegjës nga aspekti penal dhe/ose civil për shpalosjen e informatave të tilla të bërë me qëllim ose për shkak të pakujdesisë.

Nënshkrimi: _____

Vendi: _____

Data: ____/____/____

Shtojca 4: Lista Kontrolluese

Nr.	Kërkesa	Po/Jo²
1.	Kërkesa për Tenderim	
2.	a) Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë b) Zotimi i mjeteve	
3.	Draft kërkesat specifike të kualifikimit	
4.	Draft kriteri i shpërblimit Në rast të TEMF, nën-kriteret	
5.	a) Specifikimi teknik b) Para masa dhe Para llogaria c) Projekti kryesor, nëse aplikohet	
6.	Deklarata nën betim për hartuesit e specifikimeve teknike	

² ZPP kontrollon të gjitha kërkesat dhe të përcaktoj nëse janë plotësuar të gjitha kushtet. Nëse po, vazhdon me shpallje, nëse jo e kthen prapa tek NjK.